



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit, mbajtur më 27.08.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi- Gorani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Nol Nushi (PSD), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Berat Lahu (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sami Salihu (LDK), Naime Osmani (LDK), Milazim Vitija (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vjollca Rizani (LDK), Jeta Rafuna – Hasani (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani – Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Suzan Kika, (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur), Valbona Petrovci (e pavarur) dhe Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur).

Munguan: Migjen Shala (PDK), Naim Hoxha (LVV), Drilon Pireva (PSD) dhe Sokol Berisha (Grupi i pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Adrian Berisha, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, përfaqësuesit e KFOR-it, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së propozoi që pika e tetë e rendit të ditës: *“Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029 Prishtinë”*, të hiqet nga rendi i ditës, të shtyhet për sencat e radhës së Kuvendit, që pas zgjedhjeve të definohet se kush do të jetë në qeverisjen e ardhshme, e cila do të zhvilloj dhe përfundoj procesin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Halim Halimi, në emër të GP i LDK-së tha se edhe ne jemi që pika e tetë e rendit të ditës të shtyhet për njëren nga seancat e radhës së Kuvendit, andaj mendoj që me këtë punë të merret legjislatura e ardhshme.

Vala Peshku, në emër të GP i PSD-së, ngriti shqetësim rreth pikës së tetë të rendit të ditës e cila tha se është e pa pranueshme që të votohet një plan i tillë në përfundim të mandatit, andaj propozoi që kjo pikë të shtyhet dhe që me Planin Zhvillimor Komunal të merret legjislatura e ardhshme e Kuvendit.

Egzon Azemi, në emër të GP i LVV-së tha se është tejet e pakuptimt që në fund të mandatit ga një qeverisje në ikje të miratohet një plan i tillë që është aq jetik për qytetin dhe qytetarët. Propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Shefki Gashi bëri vërejte rreth këtij propozimvendimi i cili tha se ky plan rregullativ është dasht të sillet në Kuvend më herët e jo tash, kur kjo qeveri është në përfundim të mandatit dhe veq jemi edhe në kohen e fushatës.

Hafiz Krasniqi tha se një plan i tillë i cili përcakton një zhvillim të Prishtinës për periudhën kohore shumë të gjatë i një ekzekutivi në ikje, të kërkoj kaq me ngulmë që duhet të aprovohet, konsideroi se është e pa arsyeshme.

Agim Gashi kërkoi nga kryesuesi që kjo pikë e rendit të ditës të qitet në votim dhe qëndrimi politik vendos.

Adrian Berisha, drejtor propozoi që në rend të ditës të hyjnë edhe këto pika: Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never" dhe Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës "Ushtari i panjohur".

Fiknete Bejta tha se e përkrahu propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Kulturës për propozimet e dhëna që ato të hyjnë në rend të ditës.

Egzon Azemi tha se jemi pro për te dyja propozime të propozuara nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës që të hynë në rend dite për diskutim.

Hafiz Krasniqi tha se kur është fjala për figurat e rëndësishme nuk vihet ad hoc asgjëja, por paraprakisht kto tema duhet të kalojnë edhe përmes Komitetit për Politikë dhe Financa e pasatj sillen në Kuvend. Në mbledhjen e kaluar e bëra një propozim rreth rastit që ka ndodhur me tregun me shumicë dhe kërkoi të dijë pse nuk është futur edhe pse është neglizhuar kjo çështje. Pres që kjo të hyn sot në rend të ditës.

Kryesuesi i hodhi në votim pikat e propozuara nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u mitatuan dy propozimet e dhëna: Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never" dhe Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës "Ushtari i panjohur".

Osman Bllaca propozoi që në rend të ditës të hynë pika: Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Pakos ekonomike emergjente, nr. 01-400/04-64478/20, dt. 14.04.2020.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, u miratua propozimi i dhënë nga Osman Bllaca.

Po ashtu propozoi që në rend të dites të hynë edhe pika: Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për definimin e parametrave urbanë – arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese, nr. 01-011/01-82553/21, dt. 12.05.2021.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenime, miratohet edhe ky propozim.

Egzon Azemi propozoi që në rend të ditës të hynë edhe pika: Diskutim për projektet e Ndërmarrjes Publike Banesore.

Kryesuesi konstatoi se më 14 vota për, 19 kundër dhe 2 abstenime nuk u miratua propozimi i dhënë nga Egzon Azemi.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shitesë dhanë Shpend Ahmeti kryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë dhe Genc Bashota drejtor.

Me ndryshimet dhe propozimet e dhëna, Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 1 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2021 (TM 2);**
- 3. Informatë nga Drejtorja e Arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor dhe organizimi i procesit të mësimit gjatë pandemisë, për vitin shkollor 2020-2021;**
- 4. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për qytetin e gjelbër (PVQGJ);**
- 5. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunsës së Prishtinës për vitin 2020;**
- 6. Plani i veprimit i menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2020;**
- 7. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, dt. 16.06.2021;**
- 8. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen “Bregu i Diellit” në Prishtinë;**
- 9. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01-353/01-82495/21, të dt. 12.05.2021, për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19;**

10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never";
11. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës "Ushtari i panjohur";
12. Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për definimin e parametrave urbanë - arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese, nr. 01-011/01-82553/21, dt. 12.05.2021;
13. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Pakos ekonomike emergjente, nr. 01-400/04-64478/20, dt. 14.04.2020;
14. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës;
15. Pyetje dhe përgjigje;
16. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 Prill – 30 Qershor 2021 (TM2)

Për Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 Prill – 30 Qershor 2021 (TM2), diskutuan: Arbenita Murseli, Halim Halimi, Berat Lahu, Agim Gashi, Jeta Rafuna Hasani, Muhamet Selmani, Nazlie Bala, Sami Boroci, Shefki Gashi, Arbër Vokrri, Naime Osmani.

Kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit ky raport nuk mund të votohet.

Pika e tretë

Informatë nga Drejtoria e Arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor dhe organizimi i procesit të mësimi gjatë pandemisë, për vitin shkollor 2020- 2021

Për Informatën nga Drejtoria e Arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor dhe organizimi i procesit të mësimi gjatë pandemisë, për vitin shkollor 2020- 2021, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Shpresa Shala, drejtoreshë.

Lidhur me Informatën nga Drejtoria e Arsimit diskutuan edhe: Leonora Shabani – Bajraktari, Agim Gashi, Sami Boroci, Naime Osmani, Vjollca Rizani, Muhamet Selmani.

Kryesuesi tha se për shkak të kourumit pika e dytë e rendit të ditës nuk mund të votohet, Gjithashtu pika e tretë, meqenëse se është Informatë nga Drejtoria e Arsimit do të diskutohet.

Në përfundim të pikës së tretë, Kryesuesi konstatoi se për shkak të kourumit mbledhja nuk mund të vazhdoi dhe u ndërpre në orën 14:00.

Vazhdimi i mbledhjes së shtatë, më 02.08.2021, prej orës 10:00.

Para se të fillohet me pikën e katërt të rendit të ditës, Kryesuesi e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, pasi që në mungesë të kourumit nuk ka mundur të votohet.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 5 vota për, 11 kundër dhe 8 abstenime, nuk u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill – 30 qershor 2021 (TM 2).

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për qytetin e gjelbër (PVQGJ)

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 22 vota për dhe 3 kundër, u miratua Vendimi për miratimin e Planit të veprimit për qytetin e gjelbër (PVQGJ).

Pika e pestë

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2020;

Lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2020, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Osman Bllaca.

Muhamet Selmani tha se ky raport është dashtë që ta ketë ndonjë bazë krahasuese për të thënë që është më i mirë, sepse nuk e dimë çka ka ndodhur vitet e kaluara.

Egzon Azemi tha se nëse gjithçka kish me qenë pozitive në këtë raport, nëse i shohim në raport çështjet kryesore, vërejtjet më të mëdha asnjëherë nuk kanë gjetur përmirësim dhe po përsëriten vit pas viti.

Berat Lahu tha se si mund të jetë ky raport i parë pa të gjetura vetëm me disa rekomandime, mirpo raport i mirë, i shkëlqyeshëm nuk është kur ke prona komunale të cilën as nuk e menaxhon, nuk merren të hyra, andaj ekzekutivi nuk po arrin ti fusë nën kontroll ato prona. Kërkoi që në këtë drejtim të ndërmerren masa që ato prona të menaxhohen ashtu si duhet.

Agim Gashi tha se sa i përket këtij raporti, vlenë të veqohet mos planifikimi i shpenzimeve të mjeteve financiare në fushën e subvencioneve nga drejtoritë. Konsideroi se janë pak jo të arsyeshme, sepse çdo drejtori kur i kërkon në miratimin e buxhetit për vitin pasues në njëfarë mënyre e harton edhe planin, andaj bazohet në një planifikim të vetin se çka ka me subvencionuar, prandaj mendoj se janë disa gjëra që nuk mund të arsyetohen dhe me një planifikim të mirë mund të adresohen dhe mund të tejkalohen.

Hafiz Krasniqi shprehi falënderimin për gjithë ekzekutivin njëkohësisht edhe për këshilltarë që na është dhënë ky vlerësim, dhe më tej shtoi se nuk jam i kënaqur tek vlerësimi i pronave, aty nuk është bërë dhe kjo po na përsëritet rregullisht, mirëpo kjo nuk është sëmundje vetëm e Komunës së Prishtinës por pothuajse edhe në nivel qendror ende nuk është bërë vlerësimi i pasurive. Njëkohësisht edhe tek shpenzimet kontingjente gjithmonë ato po na përsëriten dhe nuk po merren si problem në përcaktimin e kualifikimit të auditorit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2020.

Pika e gjashtë

Plani i veprimit i menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2020

Kryesuesuesi konstatoi se u përkrah Plani i veprimit i menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2020.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, të dt.16.06.2021

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, të dt.16.06.2021, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Genc Bashota, drejtor.

Leutrim Retkoceri kërkoi të dijë se a mund të dëmtohet buxheti në rast se kjo taksë do të shtyhej apo do të hiqej për 6 muajt e ardhshëm duke pasur parasysh se bizneset do të ballafaqohen me një situatë të rëndë ekonomike. Nëse vazhdon në këtë masë përhapja e pandemisë atëherë edhe ato do të detyrohen të mbyllen apo edhe masat e reja do ti mbyllin e si Komunë kemi për obligim dhe përgjegjësi që bizneset lokale ti ruajmë dhe të kujdesemi për ato.

Për pyetjen e parashtruar nga z. Retkoceri, Genc Bashota drejtor dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 22 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 01-431/04-112314/21, të dt.16.06.2021.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Genc Bashota drejtor.

Shefki Gashi shprehu mendimin e tij duke cekur se sipas këtij propozimplani disi sikur jemi duke u tërheq prej kishës me zgjeruar atë me liruar territor pak më shumë ajo, prandaj dhe më duket si një e metë e këtij projekti, sepse ka vend për ndërtimin e fakulteteve, objekteve për universitet dhe brenda korpusit të universitetit.

Besnik Mujeci tha se unë mendoj që krimi më i madh që po ja e bëjmë Prishtinës është me ndërtimin e objekteve të universitetit dhe fakulteteve në atë pjesë. Ajo pjesë meriton me qenë park i qytetarëve të lagjes "Matit 1" dhe të ja ngushtojnë atë hapësirë asaj lagjeje është krimi më i madh që po i bëhet Prishtinës në këtë moment.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket projektit ne jemi për, sepse e dimë që ka pasur edhe dëgjime me qytetarë edhe parashihet një park në këtë zonë për qytetarë të cilët do ta shfrytëzojnë edhe Prishtina ashtu kështu është qytet i studentëve. Rreth këtij projekti kam një dilemë ku aty vërehet që mes dy objekteve ka hapësira jashtëzakonisht të ngushta po besojë që është çështje e arkitektëve kjo por është një vërejtje që ndoshta në planet tjera të hollësishme rregulluese na duhen hapësira më të mëdha.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Genc Bashota, drejtor.

Egzon Azemi shprehu mendimin e tij duke shtuar se në atë hapësirë ku tani propozohet ky plan rregullues, me hartë zonale aty ka qenë e planifikuar ndërtimi i sallës së operës, prandaj në rast votimi të këtij plani do të ket paknaqësi prej banorëve të asaj lagje.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 21 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit, 01-353/01-82495/21, të dt.12.05.2021, për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 26 vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit, 01-353/01-82495/21, të dt.12.05.2021, për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never"

Lidhur me caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never", të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi përfaqësuesja e Drejtorisë e Kulturës.

Për këtë propozimvendim diskutuan: Egzon Azemi, Agim Gashi, Shefki Gashi,

Hafiz Krasniqi dhe Rifat Deri.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 13 vota për dhe 10 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never".

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës "Ushtari i panjohur"

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 18 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës "Ushtari i panjohur".

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullorës për definimin e parametrave urban-arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese me nr.01-011/01-82553/21 e dt.12.05.2021

Mimoza Sylejmani ngrit shqetësim rreth këtij propozimvendimi dhe kërkoi të dijë arsyen e shfuqizimit të kësaj rregulloreje.

Kryesuesi tha se Ministria e Mjedisit ka konsideruar se kjo rregullore nuk është në përputhje me ligjin dhe kërkon të shfuqizohet.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 20 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për shfuqizimin e Rregullorës për definimin e parametrave urban-arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese me nr.01-011/01-82553/21 e dt.12.05.2021.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Pakos ekonomike emergjente me nr. 01-400/04-64478/20 e dt. 14.04.2020

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 26 vota për, u miratua Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Pakos ekonomike emergjente me nr. 01-400/04-64478/20 e dt. 14.04.2020.

Pika e katërbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës

Fiknete Bejta, ngriti shqetësim rreth formimit të këtij komisioni e cila tha se është për të ardhur keq që ky komision po konstituohet tash në fund të mandatit edhe pse kërkesa jonë ka qenë e kahershme për formimin e këtij komisioni.

Mimoza Sylejmani tha se formi i një komisioni të till në fund të mandatit, konsideroj se është i pa kuptimt.

Shefki Gashi tha se këto komisione janë trupa të Kuvendit dhe ato zgjasin sa zgjat mandati i Kuvendit dhe është e pakuptimt formimi i tij, prandaj është mirë që të jet për legjislaturën tjetër.

Halim Halimi tha se është e pa arsyeshme që të merret një vendim i tillë dhe mendoj se duhet të shtyhet për legjislaturën e ardhshme.

Egzon Azemi ishte i mendimit se formimi i një komisioni të tillë duhet të shtyhet për legjislaturën e ardhshme të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime nuk u miratua Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Prishtinës.

Pika e pesëmbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje

Hafiz Krasniqi, për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave

- Pse nuk po fillon puna për realizimin e projektit për rrjetin e kanalizimit prej Bunarit të Hajratit- Llukar – Makovc, kur dihet se të gjitha procedurat paraprake janë kryer.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Krasniqi, Valbona Makolli, drejtoreshë dha sqarime të nevojshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

